



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:018936

Datë: 23.10.2024

Numri i dokumentit: 06336209

C-IV-14-7027

Parashtruesja e kërkesës

M T, nga Prishtina

Kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) (NSH “Gërmia” në likuidim), Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakërishtë. Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 23 tetor 2024, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- I. Ankesa e ankueses refuzohet si e pabazuar.**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN093-0556 datë 18 korrik 2014.**
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 13 nëntor 2014, pranë DHPGJS, ankuesja parashtroj kërkesës, të emërtuar ankesë, për rishikimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) PRN093-0556 datë 18 korrik 2014 (tani e tutje Vendimi), me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për kompensimin e mjeteve të asistencës sociale, për periudhë e në shumë të pacaktuar, ndaj NSH “Gërmia” (në likuidim).

Ankuesja Vendimin e AL e atakon për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të dispozitave materiale.

Ankuesja pretendon në të drejtën në asistencë sociale në shumë prej 1,575.00 (një pesë shtatë pesë) Euro.

Ankuesja fillimisht kundërshtoj Vendimin e AL, në kuptim të zhvillimit të procedurës së likuidimit nga ana e AL. Ankuesja tutje konsideron se AL ka vepruar në kundërshtim me nenin 37 të Shtojcës së Ligjit për AKP.

Ankuesja përfundimisht kundërshtoj kërkesën e AL mbi dokumentacion shtesë me vetë faktin se nuk ekziston menaxhmenti i NSH dhe se i gjithë dokumentacioni gjendet në administrim të AKP.

Nga të gjitha arsyet propozoj që kërkesa e saj të aprovohet.

Kërkesës për rishikim i janë bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL,
- Kopja e shkresës drejtuar ankueses, datë 6 maj 2014, nga ana e AL-AKP, mbi dokumentacion shtesë lidhur me kërkesën e saj kreditore,
- Kopja e Njoftimit mbi iniciimin e procedurën së likuidimit të NSH,
- Kopja e shkresës informuese mbi iniciimin e procedurës së likuidimit, datë 14 gusht 2007, drejtuar ankueses,
- Kopja e kërkesës kreditore e parashtruar pranë AKP, me kërkesën e ankueses për kompensimin e asistencës sociale, në shumë prej 1,575 Euro, për periudhën nga data 1 janar 2005 gjer 14 gusht 2007,
- Kopja e vendimit, nr. 576 datë 5 qershor 2001, lëshuar nga NSH, siç thuhet vendim i përkohshëm mbi vazhdimin e procedurës sociale, dhe
- Kopja e vendimit, nr. 855 datë 4 shkurt 2003, mbi asistencën sociale të ankueses dhe atë nga data 1 janar 2003 gjer me 31 mars 2003.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 23 gusht 2024 parashtroj përgjigjen.

AKP kundërshtoj ankesën si të pabazuar. AKP mbështeti Vendimin e AL si të bazuar në dispozitat ligjore dhe në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit për AKP (shtojca e ligjit). AKP gjithashtu theksoj se ankesa nuk përmban argumentet ligjore, të përcaktuar sipas Shtojcës së Ligjit për AKP dhe Ligjit për procedurën kontestimore - LPK. AKP përfundimisht pohoj se kërkesa e ankueses është e pabazuar pasi që edhe përkundër kërkesës së AL, ankuesja nuk ka parashtruar ndonjë Vendim mbi asistencën sociale për periudhën e kërkuar, janar 2005 e gjer gusht 2007. Nga gjitha AKP propozoj që ankesa të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet Vendimi i AL.

Përgjigjes i janë bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL,
- Kopja e Vendimit për emërimin e anëtarëve të AL, dhe
- Kopja e shkresës drejtuar ankueses, datë 6 maj 2014, nga ana e AL-AKP, mbi dokumentacion shtesë lidhur me kërkesën e saj kreditore.

Përgjigja e AKP, me anë të urdhrin të gjykatës, ju dorëzua ankueses me 11 shtator 2024.

Ankuesja nuk parashtroj përgjigje.

Arsyetimi Ligjor

Kërkesa për rishikim –ankesa konsiderohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit për DHPGJS (ligji nr.06/L-086) në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Në rastin konkret bazuar sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast ankueses, që në parashtrësat e saj me shkrim, ankesën, të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsyetimit ligjor mbi të cilin vendos

qëndrimin dhe argumentimin e tij. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesja, të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Nga dispozita e cekur si më lartë, është obligim i ankueses që të dëshmoj detyrimet ndaj saj, mbi mos pagesën e kompensimit të asistencës sociale.

Ashtu siç qëndron edhe në Vendimin e AL dhe kërkesën e parashtruar pranë AL, ankuesja ka kërkuar kompensimin e asistencës sociale në shumë prej 1,575 Euro, për periudhën nga data 1 janar 2005 gjer 14 gusht 2007,

Vendimet e NSH, të parashtruara nga ana e ankueses, tregojnë të drejtën e përkohshme mbi asistencën sociale respektivisht të drejtën në asistencë sociale nga data 1 janar 2003 gjer me 31 mars 2003.

Ankuesja nuk ka ofruar argumente, si në procedurën e likuidimit pranë AL e as pranë gjykatës, me anë të kërkesës për rishqyrtim-ankesë, argumente të cilat do të dëshmonin të drejtën në asistencë, për periudhën e kërkuar, muajit janar 2005 gjer në muajin gusht 2007.

Tutje, lidhur me pagat e papaguara si dhe kompensimit, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 dhe 1.6.2 parashihet përmbushja e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person si dhe e drejta në kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në .

Nga dispozitat e lartëcekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën në paga respektivisht dëmshpërblim nëse:

- a. pagat e punonjësit, në këtë rast ankueses, nuk janë paguar;
- b. Kontrata mbi punën i është ndërprerë para afatit të përfundimit, të saj;
- c. Pushimi nga puna ka ardhur si pasojë e Vendimit të AL, dhe
- d. Ndonjë veprim nga Agjencia, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj.

Kjo dispozitë, sipas mendimit të gjykatës, do të përfshinte edhe të drejtën në asistencë sociale.

Ankuesja për më tepër nuk ka dëshmuar të drejtën e saj mbi kompensimin siç edhe parashihet sipas nenit 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 apo 1.6.2 lidhur me nenin 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS .

Nga gjitha arsyet u vendos si në dispozitiv.

Taksa Gjyqësore:

Ankuesja ka paguar taksat gjyqësore.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar